Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1052

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Hajdar Hoxhaj" kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Posta e Kosovës SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ Posta e Kosovës sha –Ritender" me numër të prokurimit vetak-23-11187-2-2-1, me 13/03/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Hajdar Hoxhaj" me nr. 2023/1052, e datës 26/12/2023, vendimi i AK Posta e Kosovës SH. A lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ Posta e Kosovës sha–Ritender" me numër të prokurimit vetak- 23-11187-2-2-1.

2. Aktiviteti i prokurimit i cituar si në pikën I të dispozitivit kthehet në **rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Hajdar Hoxhaj".

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.10.2023 Posta e Kosovës SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ Posta e Kosovës sha –Ritender" me numër të prokurimit vetak-23-11187-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 10,000.00 €.

AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me datën 08.12.2023, ku ka rekomanduar OE "Nexia KS" SHPK.

Me 13.12.2023 "Hajdar Hoxhaj"ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 15.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 12.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Hajdar Hoxhaj"me nr. 1052/23 lidhur me aktivitetin "Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ Posta e Kosovës sha – Ritender": vetak-23-11187-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16.01.2024 ka autorizuar eksperten shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1052/23, ndërsa me datë 22.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1052 me rekomandimet si në vijim: "*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të bëhet Anulimi i Njoftimit të Vendimit të Autoritetit Kontraktues, lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe të trajtohen të gjitha provat dhe dëshmitë e ofruara konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë*".

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues/teknik, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues/teknik.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues OE "Hajdar Hoxhaj" janë parashtruar si në vijim:

OE – Person Fizik, zt. Hajdar Hoxha, më ID: 1003097761 do të paraqes shqetësimin tim, kërkesën për rishqyrtim në lidhje me vendimin për rezultatin e tenderit / diskualifikimin tim nga tenderi i cekur më lartë edhe për kundër që jam në ofertën më të lirë. Kam identifikuar një mos konformitet në vlerësimin e përvojës së punës dhe kam disa pyetje dhe shqetësime në lidhje me procesin e vlerësimit. Në vlerësimin e tenderit të parë, ku jeni Referuar, na është bërë e ditur se jemi diskualifikuar për shkak se kompania "ProAudit" SH.P.K. (Person Juridik) - Prishtinë, nuk ka përvojë të mjaftueshme në hartimin e rregulloreve të ngjashme. Për më shumë në vendimin

nr. 01-1865/23 dt. 03.08.2023, AK ndër tjera thekson si "Për me tepër ne anë të këtij vendimi sqarojmë se në rastin konkret oferta është dorëzuar nga OE jo nga individ fizik. Dëshmia respektivisht faqja e parë e "Rregullore për sistematizimin e vendeve të pune në NPB Sh.A Prishtinë" me numër të protokollit 01-475/3 te dt. 25.03.2021 e hartuar nga zyrtaret e kësaj ndërmarrje ku mund të merret si dëshmi që është realizuar nga OE "ProAudit". Sa i përket vendimit të AK që Komisioni i NPB ka hartuar rregulloren, kjo nuk qëndron pasi sipas vendimit nr. 04/1-02/464-1 dt. 03.10.2018 KE (Hajdar Hoxhaj) ka Vendimin – për formimin e komisionit për inicimin e procesit të sistematizimit të vendeve të punës në NPB, mirëpo sipas pikës IV – data e përfundimit të këtij procesi është dy muaj nga aprovimi i këtij vendimi (rrjedhimisht deri më 02.12.2018), gjersa rregullorja është aprovuar me dt. 25.03.2021 (pas dy vite e gjysmë). Pra shifet qartë që kjo nuk ka asnjë ndërlidhje. Për saktësi pikërisht që komisioni nuk ka arritur të draftojë rregulloren për sistematizim, sipas kontratës dhe statutit të NPB janë angazhuar vetë së bashku më stafin në hartimin e rregulloresPër më shumë AK fillimisht është referuar në emalin e NPB si arsyetim për eliminim, tash në vendim për formim të komisionit, që të dyjat janë të pa qëndrueshme, dhe e pa kuptueshme për vetë AK ("si na qenkan dy të vërteta").

Megjithatë, në ketë procedurë të prokurimit jam përfshirë si OE – (Person Fizik), duke plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara, nga AK pasi kam demonstruar qartë rolin tim si Kryeshef Ekzekutiv i NPB në hartimin e rregullores për sistematizimin e vendeve të punës me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021 duke prezantuar Vendimin për Plotësim Ndryshim të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës, nr. 01-475/1 dt. 25.03.2021 të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Për më shumë, referuar strukturës ligjore për funksionimin e Ndërmarrjeve Publike, statuti i NPB-së nr. 01-105/1 dt.15.01.2021, neni – 26.6.7 "KE – Të themeloj dhe rishikoj strukturën organizative të shoqërisë, si dhe alokimin e fuqisë vendimmarrëse të shoqërisë, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarave në shoqëri", dhe Kontratës për themelimin e marrëdhënies se punës, në mes të palëve kontraktuese; NPB-se (Punëdhënës) dhe zt. Hajdar Hoxhaj (Punëmarrësi) më nr. 04/3-86/1 dt.25.02.2020, neni 4 – Përshkrimi i detyrave të punës, pika 5, Kryeshefi Ekzekutiv "Bën sistemimin dhe organizimin e të punësuarve konform dispozitave pozitive dhe të politikave zhvillimore të Ndërmarrjes". Referuar dokumenteve të cekura më lartë, është mese e qartë se struktura organizative, është përgjegjësi e plotë e KE. Sigurisht që një autorizim i tillë është rregulluar edhe më statutin e vetë AK – Posta e Kosovës. Rrjedhojë e kësaj, "Rregullore për sistematizimin e vendeve te punës ne NPB Sh.a Prishtine me nr te protokolit 01-475/3 te dt 25.03.2021, dhe struktura organizative, është hartuar nga zt. Hajdar Hoxha – KE, në rolin drejtues dhe mbikëqyrës në bashkëpunim më stafin profesional të NPB-së Ky ndryshim thelbësor dhe përmbajtjesor i bërë në ketë procedurë të prokurimit (ritenderim) duhet të më ketë lejuar të konsiderohem për këtë kriter, por kam vërejtur se rezultati ka qenë negativ edhe kësaj radhe. Kjo është e pakuptimtë dhe paradoksalisht kësaj radhe AK arsyeton eliminimin tim nga procedura e prokurimit si çështje „Resjudikata''(çështje e gjykuar) me vendimin 2023/0558 të OSHP-së. Për më shumë kërkoj shpjegime të detajuara rreth procesit të vlerësimit dhe arsyetimit të vendimit, ku është mëse e qartë që rastet trajtohen individualisht duke theksuar dallimin përmbajtësoj në aplikim, për më tepër rasti i gjykuar nga OSHP në tenderin e parë që kam aplikuar si person juridik dhe në atë kontest të personit juridik është si çështje e gjykuar por nuk mund të konsiderohet si çështje e gjykuar në ri tenderimin e kontestuar aktual meqenëse me këtë rast kam aplikuar si person fizik – kjo e bënë dallimin përmbajtjesor, substancial dhe material. Në këtë lidhje dua të theksoj se personi që ka hartuar rregulloren, për të cilën kërkohej përvojë në hartimin e rregulloreve, ka një eksperiencë të konsiderueshme në fushën e hartimit të rregulloreve, siç mund të konfirmohet me dokumentacionin e pranuar dhe

verifikues. Në dosjen time të tenderit si OE - Person Fizik, kam paraqitur disa dokumente konfirmuese nga entiteti (Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A) më të cilat është theksuar qartë roli dhe përgjegjësia e KE në hartimin /e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës. Kam tërhequr vëmendjen se OE - Personi Fizik i përfshirë i përfshirë në ketë proces, ka përmbushur kriteret dhe ka një përvojë të dokumentuar në hartimin e rregulloreve duke ofruar një një bazë të qëndrueshme për të përbërë një ofertë konkurruese. Mirëpres që OSHP që në përputhje më LPP pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe dëshmive përkatëse, kërkoj të bën anulimin e vendimeve të AK, dhe lëndën të kthehet në rivlerësim, rrjedhimisht ankesa e parashtruar nga OE – Individ (Hajdar Hoxhaj) të vlerësohet si e bazuar.

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues "Hajdar Hoxhaj": Ju keni dorëzuar listën e kontratave dhe komisioni i vlerësimit me datë 20.11.2023 përmes platformës së e-prokurimit përkatësisht me letër standarde kemi kërkuar kopjen e kontratave për: Zhvillimi i politikave dhe procedurave të burimeve njerëzore, politikave qeverisëse për Universitetin e Prishtinës USAID TLP 2018- 2019. Hartimi i Manualit të Burimeve Njerëzore Caritas Kosovo 2022-2023, dhe Letër Motivuese. Ju keni dorëzuar kontratat e lartpërmendura, dhe komisioni i ka analizuar dhe i ka shqyrtua dhe për të njëjtat ka ardh në përfundim se asnjëra nga këto aktivitete nuk është e ngjashme sepse asnjëra nuk ka te bëjë me Ristrukturimin e ndërmarrjeve publike, apo me ristrukturim te ndonjë institucioni. Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Lidhur me pretendimet e "Hajdar Hoxhaj"eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1052 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit: Angazhimi i konsulentit të jashtëm për mbështetjen e procesit të Ristrukturimit në NPQ Posta e Kosovës sha - Ritender: vetak-23-11187-2-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Posta e Kosovës SH.A ka publikuar njoftimin për kontratë me datë 17.10.2023 hapja e ofertave është bërë me datë 08.11.2023 si dhe vendimi për dhënie është publikuar me datë 08.12.2023. OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, me datë 12.12.2023 ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së duke pretenduar se AK ka eliminuar pa të drejtë. OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin: Autoriteti Kontraktues, Posta e Kosovës SH.A. e ka eliminuar operatorin ekonomik Hajdar Hoxhaj (person fizik) në arsyet e lartpërmendura në raportin e vlerësimit.Eksperti Shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave dhe dëshmive të lëndës sqaron se, kërkesat e Autoritetit Kontraktues nuk kanë qenë specifike me objektin e kontratës, mirëpo janë paraqitur me thirrjen " të ngjashme " dhe në kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka ekuivalencë në kërkesat për të cilat OE është eliminuar. Po ashtu gjatë analizimit të dëshmive të ofruara nga OE në njërën anë dhe kërkesave të specifikave teknike të Aneksit -1 të dosjes së tenderit po ashtu dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë eksperti sqaron se, AK duhet të ndërmarrë veprime (hapa) për shterjen e mjeteve efektive juridike, në raport me objektin e kontratës. Autoriteti Kontraktues, gjatë ri-vlerësimit duhet të bëjë ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave duke vlerësuar dëshmitë në mënyrë më analitike dhe më të detajuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues/tekniki cili ka vlerësuar se pretendimet e Ankuesit të parashtruara në OSHP janë të qëndrueshme, për faktin kërkesat e Autoritetit Kontraktues nuk kanë qenë specifike me objektin e kontratës, mirëpo janë paraqitur me thirrjen "të ngjashme" dhe në kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka ekuivalencë në kërkesat për të cilat OE është eliminuar. Po ashtu gjatë analizimit të dështmive të ofruara nga OE në njërën anë dhe kërkesave të specifikave teknike të Aneksit -1 të dosjes së tenderit po ashtu dhe kërkesave të parashtruara në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë AK duhet të ndërrmarëmarrë veprime për shterjen e mjeteve efektive juridike, në raport me objektin e kontratës.

Në bazë të gjithë kësaj Paneli vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, nisur nga bindja dhe gjykimi i pavarur i tij se ka aplikuar zgjidhjen e duhur në ketë rast. Raporti i ekspertit shqyrtues ndonëse nuk është detyrues për Panelet Shqyrtuese të cilat në proceset e vendimmarrjes ushtrojnë pavarësinë e plotë në zbatimin e kompetencave sipas nenit 105 të LPP, i njëjti në çdo rast analizohet dhe i njihet vlera provuese në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të një lënde, andaj paneli shqyrtues e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues dhe vlerëson se Autoriteti Kontraktues, gjatë ri-vlerësimit duhet të bëjë ekzamiminin dhe krahasimin e ofertave duke vlerësuar dështmitë në mënyrë më analitike dhe më të detajuar, gjithmon konform kërkesave të Dosjes së Tenderit (DT).

Arsyeja pse Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues, është se, AK nuk ka mundur me u thirr si çështje e gjykuar më parë me vendimin paraprak të OSHP Nr. 2023/0558, për shkak se kërkesa dhe dështmia e DT mbi bazën e të cilit është marrë ky vendimi nuk është e njëjtë me kërkesën dhe dështminë e DT së tanishme mbi bazën e të cilit është eleminuar OE ankues. D.t.th ka dallime të mëdha rreth ofrimit të dështmive për plotësim të kësaj kërkese.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POSTA E KOSOVËS SH.A**
- OE - **Hajdar Hoxhaj**
- Arkivës së OSHP-së: